



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KESHILLI BASHKIAK**  
**Shoqëria Aksionare “Bio Strajca”**



**Akt i Themelimit i Shoqërisë Aksionare “Bio Strajca”**

Në Shkodër, sot me datë 20/7/2023, krijohet Shoqëria Aksionare në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Shoqëria aksionare ushtron veprimtarinë e saj në territorin e juridiksionit të bashkisë Shkodër.

**Neni 1**

**Emri dhe selia**

- 1.1 Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet **“Bio Strajca”** sh.a.
- 1.2 Selia e shoqërisë është në adresën; Rr.Lëvizja e Postribës, Lagje nr.3-Shkodër.
- 1.3 Shoqëria aksionare ka logon dhe vulën e vet siç janë përcaktuar nga Themeluesi.

**Neni 2**

**Forma**

2.1 Shoqëria themelohet, organizohet dhe funksionon si shoqëri aksionare me ortak të vetëm 100% kapital bashkinë Shkodër, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

**Neni 3**

**Objekti**

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë aksionare është:
- a)Ofrimi i shërbimeve në fushën e zhvillimit ekonomik për mirëfunksionimin e tregjeve publike dhe rrjetit të tregtisë.
  - b)Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor dhe ofrimin e shërbimeve cilesore ndaj komunitetit.
  - c)Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, tregjeve të kafshëve të gjalla,thertoret etj.

3.2 Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt/indirekt në ushtrimin e veprimtarisë së saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

3.3 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 4

##### Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.

#### Neni 5

##### Kapitali

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 10 000 000 lekë. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar tërësisht nga themeluesi Bashkia Shkodër.

5.2 Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme.

5.3 Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë.

5.4 Pasuria e shoqërisë është e përbërë nga: pasuria fillestare në vlerën 10 000 000 lekë, e krijuar si kontribut fillestar i themeluesve, i derdhur nga bashkia Shkodër në llogarinë bankare të shoqërisë.

#### Neni 6

##### Drejtimi i Shoqërisë

6.1 Organet e shoqërisë “Bio Strajca” sh.a. janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli i Administrimit.

#### Neni 7

##### Likuidimi i shoqërisë

7.1 Likuidimi i shoqërisë të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

#### Neni 8

##### Dispozita të kalimtare

8.1 Shoqëria aksionare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, veçanërisht të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 ‘Për krijimin e shoqërive tregtare’, të ndryshuar.

8.2 Çështjet që nuk trajtohen në këtë akt themelimi, rregullohen në statutin e shoqërisë si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

8.3 Në rastet kur mosmarrëveshjet nuk gjejnë rregullim sipas ligjeve në fuqi palës /palëve i lind e drejta ti drejtohen Gjykatës kompetente për zgjidhjen e tyre.

